

VENDIM
Nr. 470, datë 26.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 518, DATË 20.9.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË NJË PJESE TË GODINËS,
KU USHTRON VEPRIMTARINË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT, PËR
KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT DHE PROKURORINË E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në titullin e vendimit dhe kudo në përmbajtje të tij, emërtimi “Kolegjit të Posaçëm të Apelit” zëvendësohet me “Gjykatës Kushtetuese”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Gjykata Kushtetuese do të përdorë mjediset sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçiu